

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, divizioni civile, me gjyqtarin Haki Kryeziu si dhe sekretaren juridike Fatime Hoti, punëtore pranë kësaj gjykate, në çështjen juridike të paditësit Xh. dhe S. K. që të dy nga fsh.B., Komuna e Malishevës, te përfaqësuar nga B. K. avokat nga Malisheva, ndaj të paditurës K. "I." me seli në Prishtinë, lidhur me kompensimin e dëmit material dhe jo material, me pjesëmarrjen e të autorizuarit të paditësit dhe te paditurës, në seancën e datës 21.02.2014 muar këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET kërkesëpadia e paditësve Xh. dhe S. K. që të dy nga fsh.B., Komuna e Malishevës, ndaj të paditues K. "I." me seli në Prishtinë, për shkak të parashkrimit, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësve tua kompensoj dëmin jo material dhe material për shkak të lëndimeve trupore të pësura në aksidentin e datë 14.02.2004.

Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit Xh. dhe S. K. nga B. me dt. 29.07.2010 përmes të autorizuarit A. M. avokat nga Malisheva kanë parashtruar padi ndaj të paditurës K "I." me seli në Prishtinë lidhur me kompensimin e dëmit jo material dhe material për shkak të aksidentit të dt. 14.02.2004, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadia të aprovohet si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që paditësve t'ia kompensoj dëmin në emër të dëmit jo material dhe material.

Gjykata te padituren e ka njoftuar me aktvendim lidhur me dhënien e përgjigjes në padi. E paditura me dt. 31.12.2013 ka parashtruar përgjigje në padi me të cilën e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësve, duke theksuar se është në pyetje parashkrimi i kërkesëpadiës, me arsyetimin se ka kaluar koha e paraparë me dispozita ligjore për ushtrimin e kësaj padie. Sipas përgjigjes në ankesë aksidenti ka ndodhur me dt. 14.02.2004, kurse paditësi ka ushtruar padi me dt. 29.07.2010 ku nga data e aksidenti dhe data e parashkrimit të padisë kanë kaluar më tepër se tri vite. Duke u thirrur në nenin 376 të LMD-së në të cilën thuhet se kërkesa për shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe personin që e ka bërë dëmin. Sidoqoftë kjo kërkesë parashkruhet 5 vjet nga data kur është shkaktuar dëmi.

Gjykata me dt. 08.01.2014 dhe 22.01.2014 ka mbajtur seancën pregaditore, ndërsa me dt. 21.02.2014 ka mbajtur seancën kryesore.

I autorizuari i paditësve ka mbetur në tersi pranë kërkesëpadiës duke theksuar se kërkesëpadia e paditësit është e afatshme me arsyetimin se pranë kësaj gjykate padia është parashtruar nga paditësit me dt. 29.07.2010 çka nënkupton se padinë e ka parashtruar brenda afatit 5 vjeçar që parashihet me dispozita të LMD-së, respektivisht në nenin 371 të këtij Ligji.

I autorizuari i të paditurës lidhur me kërkesëpadinë e paditësit ka mbetur në tersi pranë përgjigjes në padi si dhe pranë thënieve të parashtruara në seancat gjyqësore, ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se kërkesëpadia e paditësit është parashkruar. Sipas të autorizuarit të paditurës aksidenti ka ndodhur me dt. 14.02.2004 ndërsa padia në gjykatë është parashtruar me dt. 29.07.2010, andaj duke u bazuar në nenin 376 dhe neni 371 të LMD-së thuhet se kërkesat e shpërblimit të dëmit të shkaktuara parashkruhen për tri vite nga data kur ka mësuar për dëmin dhe personin që e ka bërë dëmin. Sipas të autorizuarit të paditurit kjo kërkesë sidoqoftë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar

dëmi, e në rastin konkret kanë kaluar më shumë se 6 vite . Nga aktgjykimi i gjykatës Komonale në Malishevë P.nr. .../... i dt. 18.10.2006, i formës së prerë po në këtë datë, rezulton se kanë kaluar më shumë se 3 vite nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, ku afati për paraqitjen e padisë ka qenë për tri vite. Sipas të autorizuarit të paditurës paditësit për shkaktimin e dëmit kanë qenë të njoftuar me dt. 14.02.2004 dhe prej atëherë kanë kaluar 6 vite, ndërsa për personin që i ka shkaktuar dëmin ka qenë në dijeni me dt. 18.10.2006 ku kanë kaluar mbi 4 vite deri në paraqitjen e padisë dhe nga e gjithë kjo rezulton se padia e paditësit është paraqitur në afat jashtë ligjore dhe e njëjta është parashkruar.

Gjykata bazuar në nenin 8 pika 1 dhe 2 të LPK-së duke i shqyrtuar të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës, duke i çmuar me ndërgjegje e të kujdesshme çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku, vërtetoj këtë gjendje faktike.

Paditësit me dt. 29.07.2010 kanë parashtruar padi pranë kësaj gjykate lidhur me kompensimin e dëmit material dhe jo material.

Aksidenti i komunikacionit sipas raportit të policisë është shkaktuar me dt. 14.02.2004 ku me aktgjykimin e gjykatës Komonale në Malishevë P.nr. .../.... e akuzuar L. K. nga fsh.D. është shpallur fajtorë për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.1, lidhur me par.3 të Kodit Penal të Kosovës, aktgjykim i dt. 18.10.2006, dhe meqenëse e akuzuara ka hjekur dorë nga ankesa , ky aktgjykim me dt. 18.10.2006 është bërë i plotfuqishëm.

Paditësit me dt. 29.07.2010 kanë parashtruar padi ku që nga koha e shpalljes së aktgjykimit e deri me datën e parashtrimit të padisë kanë kaluar mbi 3 vite.

Gjithashtu që nga data e shkaktimit të aksidentit të komunikacionit të dt.14.02.2004 e deri me parashtrimin e padisë kanë kaluar mbi 6 vite.

Sipas nenit 376 të Ligjit Marrëdhënjeve detyimore kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për 3 vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe personin që e ka bërë dëmin. Paragrafi 2 i këtij neni thotë se sidoqoftë kjo kërkesë parashkruhet për 5 vjet nga data kur është krijuar dëmi.

Bazuar në nenin 376 par.1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhënjet Detyimore padia e paditësve është parashkruar meqenëse sipas po të njëjtit nen kanë kaluar të gjitha afatet ligjore për parashtrimin e padisë, prandaj me të drejt i autorizuari i të paditurës është thirrur në institutin e parashkrimit.

Gjykata duke i analizuar të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës si dhe duke ju referuar nenit 376 par.1 dhe 2 të LMD e refuzoj kërkesëpadinë e paditësve për shkak të parashkrimit dhe për këtë vendosi si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjakovë-dega Malishevë
C.nr. 81/2010 me datën: 21.02.2014

Sekretaren juridike
Fatime Hoti

G j y q t a r i
Haki Kryeziu

UDHËZIMI JURIDIK: Ndaj këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të aktgjykimit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, përmes kësaj gjykate.